

MASTER

DEPARTAMENTI I GAZETARISË

PROGRAMI I STUDIMEVE: GAZETARI DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

SILABUSI I LËNDËS:

1. Titulli i lëndës: Intervista, Podcast dhe Talk Shou

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Intervista, Podcast and Talk Shou
Niveli:	
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III-të , Semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2 +2+4
Kreditë ECTS:	
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Mësimdhënësi: Dr. Jeta Abazi Gashi
Të dhënat kontaktuese:	Jeta.abazi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë është krijuar për të zhvilluar aftësitë praktike dhe teorike të studentëve në realizimin e zhanreve më kreative të gazetarisë bashkëkohore: intervistës, podcast-it dhe talk shoë-t. Në një kohë kur temat dhe personalitetet më të spikatura marrin formë dhe ndikim përmes këtyre formateve, lënda synon t'i pajisë studentët me njohuri mbi teknikat e realizimit, qasjet editoriale dhe mënyrat e ndërtimit të përmbajtjes tërheqëse dhe të besueshme dhe etike. Studentët do të mësojnë si të zhvillojnë intervista me vlerë gazetareske, si të strukturojnë një episod podcast-i që të rezonojë me audiencën, dhe si të menaxhojnë dinamika të një talk shoë-i të suksesshëm. Përmes analizës së modeleve ekzistuese dhe ushtrimeve praktike, ata do të kuptojnë se çfarë e bën një material të dëgjueshëm/shikueshëm edhe në epokën digjitale.
Qëllimet e lëndës:	Në thelb, kjo lëndë eksploron artin e të zotëruarit të formave mediatike që kombinojnë informacionin, personalitetin dhe ndikimin, duke e përgatitur studentin për sfidat dhe mundësitë e tregut mediatik të sotëm.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të aftësohen të mbledhin materiale në mënyrë profesionale, të hulumtojnë në funksion të përmbajtjes, të strukturojnë pyetje me vlerë gazetarie dhe të shkruajnë për formatet e intervistës, podcast-it dhe talk shoë-t. Ata do të mësojnë si të përzgjedhin dhe ftojnë të ftuar të përshtatshëm, si të ndërtojnë komunikim efektiv, dhe si të përdorin gjuhën e trupit dhe mjetet ndihmëse vizuale për të përforcuar mesazhin. Zemra e lëndës është realizimi praktik i këtyre zhanreve—nga ideja deri te produkti final—gjithmonë duke respektuar etikën profesionale dhe integritetin e të ftuarve, si dhe duke ndërtuar një marrëdhënie të besueshme me audiencën.
-----------------------------------	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (90min)	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	15	1	15
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren	0		0
Testi, punimi i seminarit	8	2	16
Detyrë shtëpie	3	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	40
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	5	2	10
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			162.5 orë

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata do të ndahen në pjesën e ligjërimit, detyrave dhe pjesë interaktive.
Metodat e vlerësimit:	5% Pjesëmarrja 15 % Detyrat 20% Ushtimet 20% Produkti i dorëzuar 40% Audio apo Video Detyra (detyrat pranohen edhe me telefona)

Literatura primare:	□ Sesno, F. (2017). <i>Ask More: The Power of Questions to Open Doors, Uncover Solutions, and Spark Change</i>. New York: AMACOM. □ Papalia, A. (2024). <i>Interviewology: The New Science of Interviewing</i>. New York: HarperCollins. □ Dowling, D. O. (2023). <i>Podcast Journalism: Audio Storytelling for Investigative Reporting</i>. Neë York: Columbia University Press. □ Winfrey, O. (2017). <i>The Wisdom of Sundays: Life-Changing Insights from Super Soul Conversations</i>. NewYork: Flatiron Books.
Literatura shtesë:	Roland Qafoku; “50 pyetje me 50 personazhe” (2021) Lumnije Berisha – “Zëra Hibrid” (2024)

Hartimi i planit mësimor	
Java	Hyrje në Lëndë (përkshrim i lëndës)
Java 1:	Pse Intervista, Podcast dhe Talk Shoë
Java 2:	Arti i hulumitimit të temtës
Java 3:	Arti i shkruarit të pyetjeve
Java 4:	Si dallon shkrimi dhe realzimi i pyetjeve
Java 5:	Rëndësia e etikës dhe integritetit
Java 6:	Si të tërheqim audincën me besim?
Java 7:	Si të promovojmë intervistën/podcast/talk show?
Java 8:	Tema apo personaliteti apo moderator?
Java 9:	Java e Testit
Java 10:	Përgatitja e një zhanri
Java 11:	Disktuim i përzgjedhjes së temës apo musafirëve
Java 12:	Shikojmë dhe mësojmë
Java 13:	Publiku kosovar dhe publiku global
Java 14:	Mjetet Vizuele
Java 15:	Përmbledhje
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	

